

**STATUTI I SHOQËRISË
“E & L Bakery” shpk**

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot, më 01.11.2023 unë Gentian Bicja themelues, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “E & L Bakery” shpk.

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z. Gentian Bicja**, shtetas Shqiptar, lindur më 09.07.1985, në Tiranë, Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar;

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryeje aktivitetin e mëposhtëm:

2.1. Shoqëria “E & L Bakery” shpk ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

2.2. Veprimtaria e Shoqërisë “E & L Bakery” shpk do të ketë për objekt: “Furrë Buke”

2.3 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakësohet në bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme.

2.4 Gjithashtu shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjeter që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

3.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë për një periudhë kohore të pacaktuar.

Neni 4

Selia

4.1 Selia e Shoqërisë “E & L Bakery” shpk është: Rruga e Thesarit, njësi, katër i parë, Linzë, Tiranë.

Neni 5
Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar filletar i shoqërisë është 100,000 (një qind mijë) lekë dhe nuk është paguar. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si mëposhtë:

- Z. Gentian Bicja, zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (një qind mijë) lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyre, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e përgjithshme e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në

 1

Neni 8 Organ i Vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Përgjithshme Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimit;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimit;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9 Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10 Kuorumi

10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoruminit të përmendor më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

11.1 Asambleja e përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të zotëruar të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13 Administrimi

13.1 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë:

- a) Z. Gentian Bicja, shtetas shqiptar, lindur më 09.07.1985, në Tiranë, Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar i cili emërohet për një periudhe 5 (pesë) vjeçare

Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

14.1 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin përmes Qëndrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raporton përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit

15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vemendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mënyrë;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm përritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi cështjet, përfshirë cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanjoë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.



Neni 16
Viti Financiar

16.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

Neni 17
Prishja dhe likujdimi

17.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:

- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit

Neni 18
Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

18.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në perputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 19
Baza Ligjore

19.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe cfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20
Mosmarrëveshjet

20.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21
Kopjet

21.1 Ky dokument redaktohet në 3 (tre) kopje origjinale.

Neni 22
Regjistrimi i shoqërisë në QKB

22.1 Për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, emërohet Gentian Bicja, administrator i shoqërisë.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nënshkruar nga ortaku themelues.

Data: 01.11.2023

ORTAK THEMELUES
Gentian BICJA

Gentian Bicja
